



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR CAKTIMIN E DISA QENDRAVE TË VOTIMIT NË NDËRTESA PRIVATE, PËR ZGJEDHJET
PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR 2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 08.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI-	Kryetar
Denar	BIBA-	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	Bitri-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Caktimin e disa qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 93, pika 2, gërma "a", e Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

V E R E N

Kryetari i Bashkisë, në zbatim të neneve 62, pika 4, dhe 93, pika 2 dhe 3, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, në rast të pamundësisë të caktimit të vendndodhjes së QV-së në ndërtesë publike, brenda territorit të qendrës së votimit, apo në zonë votimi fqinje, ka detyrimin t'i propozojë KQZ-së propozimin për caktimin e QV në ndërtesë private.

Kryetarët e Bashkive Has, Krujë, Kavajë, Tiranë, kanë paraqitur propozimet për caktimin e QV në ndërtesa private.



Propozimet janë shoqëruar me të dhëna dhe dokumentacion në përputhje me përcaktimet e nenit 93, pika 3, të Kodit Zgjedhor, dhe Udhëzimin e KQZ-së Nr.1, datë 12.12.2012 "Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së qeverisjes vendore për zgjedhjet".

Në zbatim të nenit 93, pika 4, të Kodit Zgjedhor, sipas urdhërimit të KQZ u krye verifikimi në terren për propozimet për caktimin në ndërtesa private të QV nr.2686, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Gramsh, QV-ve nr.3003, 3009, 3009/1, 3155 paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Fier, Qv nr.4009, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë Devoll.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 93, pika 2, gërma "a" të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

V E N D O S I

1. Caktimin e qendrave të votimit në ndërtesa private, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes Nr.1, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Vendodhjet e QV nr.3003, Njesia Adm.3 Bashkia Fier, QV-së nr.3009, QV-së nr.3009/1 Njesia Adm.1 Bashkia Fier, të caktohen në ambiente publike, sikundër kanë qënë në Zgjedhjet e mëparshme.
3. Kryetari i Njësisë së Qeverisjes Vendore të kryejë menjëherë lajmërimin me shkrim të zgjedhësve për vendndodhjen e qendrës së votimit, të caktuar me këtë vendim.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

